

Kurti, opozitës:
'Zajednica' nuk ka kaluar
në gjykatë e popull, s'kalon
as në qeveri | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË DELEGACIONI I LARTË I ZYRTARËVE DHE BIZNESEVE
AMERIKANE KA VIZITUAR KOSOVËN | FAQE 4-5

DISKUTOHET PËR RRRITJEN E INVESTIMEVE AMERIKANE NË KOSOVË



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në takim një delegacion të lartë të zyrtarëve e bizneseve të ndryshme amerikane të organizuar nga Zyra e Partneriteteve

Globale e Departamentit amerikan të Shtetit. Në takim me delegacionin e lartë amerikan, Osmani ka biseduar mbi potencialin e bashkëpunimit ekonomik, rritjen e investimeve

amerikane në Kosovë, si dhe fuqinë e re e të kualifikuar punëtore. Ajo ka folur edhe për faktin se Kosova është në një kohë të rëndësishme të përcaktimit të së ardhmes energjetike

NË KOSOVË NUK KA RASTE TË KONFIRMUARA ME FRUTH

| FAQE 3



SENATORËT AMERIKANË KËRKOJNË QË KOSOVA DHE SERBIA TË PAJTOHEN PËR PLANIN E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

| FAQE 5



AKTUALE



TROMP: VIKTIMA U VRA NGA
PLUMBI SERB, SPECIALJA E DËNOI
SALIH MUSTAFËN | F. 3

JAVËN E ARDHSHE DO TË
MBAHEN TRI SEANCA, NJËRA
PËR PËRVJETORIN E "EPOESË
SË UÇK-SË" | F. 3

ÇFARË E KËRCËNON SIGURINË
PUBLIKE DHE KOMBËTARE
TË KOSOVËS? | F. 7

NËNSHKRUHET MARRËVESHJE
MES MASHTI-T DHE UP-SË PËR
AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA | F. 7

EKONOMI



RIZVANOLLI PËRFAQËSON KOSOVËN
NË FORUMIN PËR KLIMË
DHE ENERGJI NË ZAGREB | F. 8

SPORT



THAQI: PRES FITORE NDAJ
LLAPIT QË TA VAZHDOJMË
RRUGËN DREJT TITULLIT | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania i kërkon Zvicrës t'ia shesë tanket Leopard 2

BERLIN, 3 MARS - Gjermania i ka kërkuar Zvicrës që t'ia shesë asaj disa nga tanket e veta Leopard 2, tha qeveria zvicerane më 3 mars, përmes një marrëveshjeje që mund të lejojë Gjermaninë dhe vendet e tjera ta rritin ndihmën ushtarake për Ukrainën.

Gjermania kërkon që Zvicra të shesë disa nga tanket të prodhuesi origjinal i tyre, Rheinmetall, i cili do t'i lejonte kompanisë të mbështesë zbrazëtitë e krijuara në Bashkimin Evropian dhe tek anëtarët e NATO-s.

Gjermania, Polonia, Portugalia, Finlanda dhe Suedia janë ndër vendet që po dërgojnë tanke Leopard për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet kundër pushtimit rus, duke krijuar boshllëqe në arsenalet e tyre. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius dhe ministri i

Ekonomisë Robert Habeck, informuan ministrin zviceran të Mbrojtjes Viola Amherd për projektin, përmes një letre të dërguar më 23 shkurt.

Politikanët gjermanë i kërkuar homologes së tyre zvicerane që të pajtohej me shitjen, me garancinë që tanket zvicerane nuk do të transferoheshin në Ukrainë. "Nuk do të kishte asnjë transferim të mëtejshëm të tankeve në Ukrainë", tha për agjencinë e lajmeve Reuters një zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes së Zvicrës.

Sipas ligjeve të saj të neutralitetit dhe një embargoje të veçantë për armët, Zvicra e ka të ndaluar të dërgojë armë direkt në Ukrainë.

Ministrja zvicerane e Mbrojtjes, Viola Amherd, u përgjigj përmes një letre më 1 mars se një shitje e mundshme e një pjese të flotës së tankeve zvicerane do të

kërkonte që Parlamenti zviceran të deklaronte zyrtarisht se tanket janë jashtë shërbimit. "Diskutimet për këtë çështje aktualisht janë duke u zhvilluar në Parlament", shtoi zyrtari i ministrisë.

Ushtria zvicerane aktualisht ka 134 tanke Leopard 2 në shërbim dhe një 96 të magazinuara. Qeveria nuk bëri të ditur numrin e tankeve që Gjermania ka kërkuar t'i blejë, por zyrtari zviceran tha se një gjë e tillë mund të bëhej me një numër të kufizuar të tankeve.

Asnjë informacion nuk u dha se kur Parlamenti zviceran mund të vendosë për këtë çështje, megjithëse qeveria tha se do të komentojë më tej këtë çështje të hënën, më 5 mars.

Zvicra më parë ka bllokuar kërkesat e Gjermanisë, Spanjës dhe Danimarkës për të lejuar riksportimin e municioneve të



prodhuara në Zvicër, në Ukrainë.

Por çështja po bëhet gjithnjë e më përçarëse në Zvicër, ku duket se Ukraina ka mbështetje të gjerë në publik dhe politikë, duke bërë që të shtohet presioni ndaj qeverisë për t'i dhënë fund ndalimit të eksporteve të

armëve zvicerane në zonat e luftës.

Thirrjet nga fqinjët evropianë për Zvicrën për të lejuar transferime të tilla në Kiev janë shtuar, dhe dy komitetet e sigurisë së Parlamentit kanë rekomanduar që rregullat të lehtësohen.

Një person i vdekur dhe pesë të lënduar nga shpërthimi i bombës në Podgoricë

PODGORICË, 3 MARS - Një person ka humbur jetën dhe pesë janë lënduar nga shpërthimi i një bombe në ndërtesën e Gjykatës Themelore në Podgoricë, konfirmon policia.

Sërgjan Koraq nga Policia Kriminale u tha gazetarëve se 39-vjeçari nga Podgorica vdiq pasi aktivizoi mjetin shpërthyes. "Ka shumë të ngjarë që ai të ketë aktivizuar mjetin shpërthyes me fuqi të madhe shkatërruese kur ka hyrë në ndërtesën e Gjykatës Themelore", tha Koraq.

Policia më vonë deklaroi se ka shumë të ngjarë që mjeti shpërthyes të ishte një granatë dore.



Koraq ka konfirmuar se kanë mbetur të lënduar pesë persona dhe se ata janë dërguar në Qendrën Klinike. Drejtoresha e Qendrës Klinike

të Malit të Zi, Lilana Radulović, ka bërë të ditur se pesë të lënduarit janë në gjendje stabile shëndetësore. "Procedurat diagnostike janë

duke u zhvilluar për të konstatuar lëndimet. Më e rëndësishmja është që të gjitha të kenë parametra vitalë stabil", tha Radulović. Ajo bëri të ditur se gjithsej shtatë persona kërkuar ndihmë mjekësore pas shpërthimit në gjykatë. Policia ka konfirmuar se shpërthimi ka ndodhur në orën 11:35 dhe se hetimet janë duke vazhduar.

Të lënduar janë avokati Branimir Vukçević, dy qytetarë, ka bërë të ditur kryetari i Odës së Avokatëve, Zdravko Begović. Kryetarja e Gjykatës Themelore, Zhelka Jovović,

tha se për nivelin e sigurisë së gjykatës kanë bërë paralajmërimet me vite të tëra. "Ne kemi folur për këtë për tre vjet. Ne po theksojmë se siguria është ashtu siç është. Fatmirësisht kështu përfundoi, mund të ishte shumë më keq", ka thënë ajo. Partia Demokratike e Socialistëve, e kryesuar nga Milo Gjukanović, u bëri thirrje autoriteteve që të informojnë sa më shpejt opinionin për detajet e ngjarjes tragjike.

Nga kjo parti njoftuan se "do të kërkojnë përgjegjësi personale të atyre që kanë mundur ta parandalonin tragjedinë, por nuk e bënë".

Shkon në 57 numri i të vdekurve nga përplasja e trenave në Greqi

ATHINË, 3 MARS - Numri i të vdekurve nga përplasja e trenave më 1 mars në Greqi është rritur në 57, raporton BBC.

Një tren me pasagjerë është përplasur me një tren mallrash në veri të Greqisë, duke lënë edhe mbi 100 tjerë plagosur.

Ministri grek i Transportit, Kostas Karamanlis, ka dhënë dorëheqje "në shenjë respekti ndaj njerëzve që vdiqën në mënyrë të padrejtë". Ai tha se ai kishte bërë "çdo përpjekje" për të përmirësuar sistemin hekurudhor të Greqisë, që sipas tij, "nuk nuk i përshtatet shekullit të 21-të".

Ekipet e shpëtimit kërkuar deri në orët e vona të së mërkurës për të mbijetuar mes rrënojave të trenave, në atë që tashmë konsiderohet si përplasja hekurudhore më vdekjeprurëse e vendit.

Kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis, e quajti përplasjen e trenit të pasagjerëve dhe një treni mallrash "një aksident të tmerrshëm hekurudhor pa precedent në vendin tonë" dhe u zotua për një hetim të plotë dhe të pavarur.

Ai tha se duket se përplasja ishte "kryesisht për shkak të një gabimi

tragjik njerëzor", por nuk dha hollësi.

Autoritetet greke arrestuan drejtuesin e stacionit të trenit në qytetin e Larisës. Ata nuk e publikuan emrin e këtij personi apo arsyeve të arrestimit, por drejtuesi i stacionit është përgjegjës për trafikun hekurudhor në atë pjesë të shinave.

Treni me rreth 350 pasagjerë ka qenë duke udhëtuar nga Athina për në qytetin verior të Selanikut. Shumë prej udhëtarëve ishin studentë që ktheheshin nga festimet e karnavaleve.



Javën e ardhshme do të mbahen tri seanca, njëra për përvjetorin e “Epopesë së UÇK-së”

PRISHTINË, 3 MARS - Nën drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca dhe me pjesëmarrjen e kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës. Kryesia vendosi që të hënën, më 6 mars, në orën 12:00, Kuvendi të mbledhet në seancë për nder të “Epopesë së UÇK-së”. Kurse, të mërkurën, më 8 mars, në orën 12:00, Kuvendi do të mbledhet në seancë plenare, për ta vazhduar shqyrtimin dhe votimin e pikave të seancave të papërfunduara. Po ashtu, u vendos që të enjten, më 9 mars, në orën 10:00, Kuvendi të mbajë seancë të re plenare. Kështu, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet ta shqyrtojë në lexim të dytë Projektligjin nr. 08/L-137 për

Pyjet dhe Projektligjin nr. 08/L-172 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve. Kuvendi do t'i vazhdojë punimet me shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 08/L-212 për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor dhe të Projektligjit nr. 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158. Më pas, Kuvendi do ta shqyrtojë raportin e performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2021, për të vijuar me shqyrtimin e rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit “Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra”, si dhe me shqyrtimin e



**EPOPEJA E
USHTRISË
ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS**

përvjetje.

rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit “Performanca financiare dhe operative NP ‘Trepça Sh.A’”. Seanca do t'i vazhdojë punimet

me votimin për emërimin e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të sekretariatit ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe

shqyrtimin e mocionit të shtatë (7) deputetëve: Projekt-Deklaratë në mbështetje të Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF).

Tromp: Viktima u vra nga plumbi serb, Specialja e dënoi Salih Mustafën

HAGË, 3 MARS - Gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve është i katërti që nis në Speciale në përgjithësi dhe i treti për akuzat direkte për krime lufte, krime kundër njerëzimit. I pari ishte ai kundër ish-komandantit lokal të UÇK-së në Zonën e Prishtinës, Salih Mustafa, i cili përfundoi më 16 dhjetor 2022, me verdiktin e shkallës së parë prej 26 vjetëve burgim për të akuzuarin. Nevenka Tromp, autore e librit “Gjykimi i papërfunduar i Sllobodan Millosheviqit”, i ka dhënë një intervistë gazetarit të “Klan Kosovës”, Besnik Tahiri, nga Haga. Në këtë intervistë, Tromp, që punoi me ekipin e prokurorit që ka ndjekur dhe përgatitur rastin kundër Sllobodan Millosheviqit, thotë se Salih Mustafa u dënua për një vrasje që e kryen forcat serbe.



“Gjykimi në rastin e Salih Mustafës ishte absolutisht një shembull i rëndësishëm se si

gjërat mund të shkojnë gabim dhe se si gjykatësit mund të bëjnë gabime. Fillimisht duke

dhënë një dënim kaq të madh, 26 vjet për disa ditë luftë dhe për krime të cilat kur i lexoj gjykimet

nuk jam e bindur se si Salih Mustafa ka mundur që të ketë përgjegjësi. Për shembull për një viktimitë që është braktisur në një kompleks ku bashkëpunëtorët shqiptarë janë mbajtur dhe është braktisur dhe vranë nga një plumb serb, nga forcat serbe dhe megjithatë gjykatësit thonë, ‘në rregull, serbët e kanë vranë, por Salih Mustafa është përgjegjës për vrasjen’. Këto janë gjërat për të cilat ju gazetarët e Kosovës, komuniteti i intelektualëve të Kosovës, duhet të reagoni, dhe jo të prisni për gjykimin e dytë, për gjykimin final në shkallën e dytë, në Gjykatën e Apelit, por ju duhet ta ngrehni zërin dhe të tregoni se çfarë vërtet ka ndodhur, se ki ndodhur. Nuk mund të lejoni që gjykatësit dhe avokatët ta shkruajnë historinë tuaj”, ka theksuar Nevenka Tromp.

Inaugurohet Shkolla Kombëtare e Kërkimit në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit

PRISHTINË, 3 MARS - Të premten është inauguruar Shkolla Kombëtare e Kërkimit në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ishte i ftuar si një nga folësit kryesor në këtë ceremoni. Në fjalën e tij, ai tha se digjitalizimi padiskutim po formëson të tashmen dhe të ardhmen tonë dhe se roli dhe potenciali i tij nuk mund të kontestohen në vitin 2023. Kurti shprehu përkushtimin e qeverisë në përdorimin e teknologjisë për të rritur transparencën dhe

llogaridhënien në qeverisje, për t'i përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset tona dhe për ta rritur produktivitetin dhe konkurrencën e ekonomisë sonë. “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në vendin tonë ka një potencial të madh. Këtë muaj do të arrijmë mbulimin e plotë të zonave të banuara me infrastrukturë të internetit broadband. Me një industri dhe komunitet të gjallë, TIK-u është një nga sektorët e paktë ku kemi një bilanc pozitiv tregtar. Pra, nuk është befasi që procesi i vazhdueshëm i vlerësimit të Strategjisë së

Specializimit të Zgjuar e ka identifikuar tashmë TIK-un si një nga pesë sektorët prioritarë në ekonominë tonë që kanë potencialin më të lartë për rritje dhe inovacion”, ka deklaruar kryeministri Kurti. Shkolla Kombëtare e Kërkimeve, sipas kryeministrit, është një bllok i rëndësishëm ndërtimi i progresit që synojmë të krijojmë dhe se programi do të ndihmojë në zhvillimin e ideve inovative që kanë potencial për të krijuar produkte, biznese dhe vende pune të reja dhe për këtë arsye do ta udhëheqin këtë vend drejt hapave transformues.





NJË DELEGACIONI I LARTË I ZYRTARËVE DHE BIZNESEVE AMERIKANE KA VIZITUAR KOSOVËN

Diskutohet për rritjen e investimeve amerikane në Kosovë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në takim një delegacion të lartë të zyrtarëve e bizneseve të ndryshme amerikane të organizuar nga Zyra e Partneriteteve Globale e Departamentit amerikan të Shtetit. Në takim me delegacionin e lartë amerikan, Osmani ka biseduar mbi potencialin e bashkëpunimit ekonomik, rritjen e investimeve amerikane në Kosovë, si dhe fuqinë e re e të kualifikuar punëtore. Ajo ka folur edhe për faktin se Kosova është në një kohë të rëndësishme të përcaktimit të së ardhmes energjetike

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në takim një delegacion të lartë të zyrtarëve e bizneseve të ndryshme amerikane (Partnership Opportunity Delegation-POD) të

organizuar nga Zyra e Partneriteteve Globale e Departamentit amerikan të Shtetit. Në takim me delegacionin e lartë amerikan, Osmani ka biseduar mbi potencialin e bashkëpunimit ekonomik, rritjen e investimeve amerikane në Kosovë si dhe fuqinë e re e të kualifikuar punëtore. Nisur nga interesimi i kompanive për zhvillimet në sektorin e energjisë, presidentja Osmani foli për faktin që Kosova është në një moment të rëndësishëm të përcaktimit të së ardhmes energjetike dhe foli për fokusin e

veçantë drejt dekarbonizimit. Ajo potencoi rëndësinë e diversifikimit si dhe integritet masiv të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, duke garantuar sigurinë e furnizimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori. Në takim u bisedua edhe për mundësitë e shumta për projekte të cilat janë në interes të përbashkët e gjeostrategjik për Kosovën dhe Shtetet e Bashkuara. Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka folur mbi aleancën e fortë me Shtetet e Bashkuara, të bazuar në vlera të përbashkëta. Presidentja ka theksuar se përqendrimi i institucioneve të

Republikës së Kosovës në forcimin e sundimit të ligjit, progresi i cili njihet edhe ndërkombëtarisht, është indikacion i përkushtimit të palëkundur për rritje të qëndrueshme ekonomike si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. POD-të janë një nismë që kanë për qëllim nxitjen e bashkëpunimit më të thellë midis Shteteve të Bashkuara, vendeve me rëndësi strategjike, si dhe sektorit privat. Kjo nismë eksploron një gamë të gjerë partneritetesh të mundshme për të bashkëpunuar në projekte specifike që avancojnë prioritetet e politikave të përbashkëta.

Kurti, opozitës: “Zajednica” nuk ka kaluar në gjykatë e popull, s’kalon as në qeveri

PRISHTINË, 3 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka thënë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në një seancë të re, e cila u mbajt në orën 22:00 të enjten në mbrëmje, se marrëveshja bazë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përbën një hap të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve të jashtme, ndërkombëtare ndërmjet dy shteteve të pavarura. Kryeministri Kurti ka thënë se ajo bazohet në parimin e barazisë së sovranëve, respektin për integritetin territorial, pavarësinë, heqjen dorë nga pengesat për anëtarësim të Republikës sonë në organizata ndërkombëtare, shkëmbimin e misioneve diplomatike përmes ambasadorëve të rangut të plotfuqishëm, njohjen e simboleve shtetërore, të pasaportave e kështu me radhë.

Kurti tha se marrëveshja i hap rrugë republikës sonë për anëtarësim në shumë organizata ndërkombëtare, më e rëndësishmja përmes pranimit të kapacitetit ligjor për t’u anëtarësuar në NATO dhe nënshkrimin e një Partneriteti për Paqe me NATO-n. Ai ka thënë se ka vërejtur që ka edhe shumë keqkuptime e informacione të pavërteta në lidhje me disa nga pikat e marrëveshjes. “Më lejoni të ritheksoj që premisa bazë e imja si kryeministër është që nuk do të lejoja të negocioja asgjë që nuk është në përputhje me sistemin kushtetues e ligjor të Republikës, apo diçka që synon territorializimin, monoetnicitetin apo krijimin e urave për ndërhyrje të Serbisë në punët e brendshme të Republikës së

Kosovës. Asnjë nga kjo, asnjëherë. Gabimet politike, historike të qeverive të kaluara nuk do të përsëriten asnjëherë, përkundrazi do të bëj përpjekje maksimale që ato gabime politike, historike të qeverive të kaluara t’i eliminoj, apo së paku t’i reduktoj substancialisht që të mos jenë pengesë për karakterin e qëndrueshëm demokratik e unitar të Republikës sonë”, ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka deklaruar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe ka kaluar në Kuvend, por nuk ka kaluar në Gjykatën Kushtetuese, nuk ka kaluar as në popull e as në qeveri. “Zajednica ka kaluar këtu në Kuvend, Zajednica nuk ka kaluar në gjykatë, nuk ka kaluar as në popull e nuk kalon as në kryeministri e qeveri, por te ju ka kaluar”, u ka thënë Kurti



deputetëve të opozitës. Kurti gjatë fjalës së tij në Kuvend ka thënë se Beogradi zyrtar gjatë negociatave që nga vjeshta e vitit të kaluar ka insistuar që marrëveshja të bëhet pasi ta zbatojmë Asociacionin, por kjo nuk u bë dhe, sipas tij, është fitore për Kosovën. “Gjatë negociatave

që kemi zhvilluar tërë vjeshtën e kaluar dhe këtë dimër insistimi i Beogradit është të bëjmë marrëveshje pasi të zbatojmë Asociacionin dhe kjo nuk u bë, pra kjo është fitore e jona. S’është e imja, por e Kosovës dhe qëndrueshmërisë së saj”, ka theksuar Kurti.

Senatorët amerikanë kërkojnë që Kosova dhe Serbia të pajtohen për planin e zbatimit të marrëveshjes

PRISHTINË, 3 MARS - Në një deklaratë të përbashkët, senatorët amerikanë të Nënkomitetit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë për Evropën dhe Bashkëpunimin Rajonal të Sigurisë, kërkuan nga liderët e Kosovës dhe Serbisë që të pajtohen për planin e zbatimit të Propozimit Evropian - Marrëveshjes drejt normalizimit mes dy vendeve.

Pas takimit të 27 shkurtit në Bruksel, përfaqësuesit e

Bashkimi Evropian thanë se edhe Kosova, edhe Serbia e kanë pranuar tekstin, siç e quajnë ata, marrëveshje bazë dhe pritet në vazhdim të diskutohet për planin e zbatimit të saj.

Senatorët, të cilët vizituan Kosovën dhe Serbinë në muajin prill të vitit të kaluar, uruan qeveritë e Serbisë dhe Kosovës për "arritjen e një marrëveshjeje të përkohshme për normalizimin e marrëdhënieve".

Marrëveshja pritet t'i zhblokojë

mundësitë për të dyja vendet, duke përfshirë ndjekjen e rrugës së anëtarësimit në BE dhe integrimin ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor, thanë ata.

Kjo marrëveshje përfshin zotimin e Kosovës dhe Serbisë për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në

proceset integruese.

Senatorët theksuan implikimet e rëndësishme të marrëveshjes për Ballkanin Perëndimor, ku "ndikimi rus kërkon ta minojë unitetin transatlantik".

"Marrëveshja dhe aneksi i zbatimit kanë implikime të rëndësishme për rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku ne e dimë se [presidenti rus, Vladimir] Putini po kërkon ta minojë unitetin transatlantik dhe ta zgjerojë ndikimin rus", thuhet në

deklaratë.

Ky grup i senatorëve, i përbërë nga demokratët dhe republikanët Jeanne Shaheen dhe Pete Ricketts - që janë në krye të Nënkomitetit - dhe senatorët Thom Tillis, Chris Murphy, Ron Johnson dhe Chris Van Hollen, u zotuan të punojnë me qeverinë e Kosovës dhe të Serbisë "për ta finalizuar aneksin e zbatimit dhe avancimin e prioritetëve që sjellin paqe, stabilitet dhe prosperitet në rajon".



Vuçiçi takon Hillin: Formimi i Asociacionit është me 'rëndësi prioritare'

PRISHTINË, 3 MARS - Pas një takimi në Beograd, ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, dhe presidenti serb, Aleksandër Vuçiçi, u pajtuan që formimi urgjent i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është me rëndësi prioritare, ka njoftuar Presidenca e Serbisë.

Vuçiçi ka shkruar në profilin e tij në "Instagram" më 3 mars se e ka informuar ambasadorin Hill për raundin e fundit të bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës i cili u mbajt më 27 shkurt në Bruksel.

Veç formimit të Asociacionit, presidenti serb tha se "duhet shumë përpjekje, punë dhe diskutime për zgjidhjen e problemeve të akumuluar në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë". Ai tha se të premtën

ka biseduar edhe me ambasadorin britanik në Beograd, Shan McLeod, për hapat e mëtejshëm për ta formuar sa më parë Asociacionin.

Në takimin e së hënës, Vuçiçi dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u pajtuan për propozimin evropian-marrëveshjen drejt normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë. Por, palët nuk e nënshkruan këtë dokument, për të cilin një zyrtar i BE-së tha dje se duhet të nënshkruhet bashkë me aneksin ose planin e zbatimit.

Në nenin 10 të marrëveshjes drejt normalizimit thuhet se "palët konfirmojnë detyrimin e tyre për t'i zbatuar të gjitha marrëveshjet e mëparshme në dialog, të cilat mbeten të vlefshme dhe detyruese". Në praktikë, kjo do të thotë se duhet

të formohet edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha në një konferencë virtuale me gazetarë, më 28 shkurt, se Asociacioni duhet të formohet dhe se ai duhet të përfaqësojë "një nivel të vetëmenaxhimit, që nuk do të ndërhyjë në rendin kushtetues të Kosovës, në strukturën juridike dhe as funksionalitetin e Kosovës".

Problemi kryesor për formimin e Asociacionit lidhet me kompetencat e tij.

Në dhjetor të vitit 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet për formimin e Asociacionit nuk janë në përputhje me 23 nene të Kushtetutës, që kryesisht kanë të bëjnë me barazinë para ligjit, të



drejtat dhe liritë themelore dhe të drejtat e komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre. Kurti, duke iu referuar këtij

vendimi të Gjykatës Kushtetuese, ka përsëritur vazhdimisht se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik.

Konfiskohet mall i kontrabanduar në Jarinjë

PRISHTINË, 3 MARS - Policia e Kosovës, në vazhden e aktivitetit në luftën për parandalimin e kontrabandës, bazuar në analizën e informatave, më 3 mars rreth orës 06:08, në pikën e kontrollit tek Ura e Bistricës, magjistranja Mitrovicë-Jarinje, ka ndaluar një autobus, me vozitës mashkull kosovar serb, i cili ishte duke qarkulluar nga drejtimi i Leposaviqit në drejtim të

Mitrovicës. Gjatë kontrollimit është vërejtur se në bagazhet e autobusit ka një sasi të madhe të mallit që dyshohet i kontrabanduar nga Serbia (laptop, monitor, pjesë kompjuterike, telefona, pjesë të telefonave mobilë, pjesë të automjeteve).

Për të gjitha rrethanat e rastit është njoftuar prokurori i Prokurorisë Themelore në

Mitrovicë dhe me autorizim të tij është iniciuar rasti "kontrabandim me mall".

Malli dhe automjeti janë sekuestruar dhe janë dërguar në terminalin doganor në Mitrovicë për procedura të mëtutjeshme ligjore, ndërsa i dyshuari, me urdhër të prokurorit, pas intervistimit, është liruar në procedurë të rregullt.



Në Kosovë nuk ka raste të konfirmuara me fruth

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MARS - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë nuk ka raste të konfirmuara me fruth. Në njoftimin për medie thuhet se duke marrë parasysh që raste të kësaj sëmundje së fundi janë regjistruar në shtete të ndryshme të botës dhe në vendet e rajonit, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës u bënë thirrje prindërve ta respektojnë kalendarin e rregullt të vaksinimit në Kosovë dhe t'i vaksinonjë fëmijët e tyre kundër kësaj sëmundjeje. "Në Kosovë nuk ka për momentin raste të konfirmuara të fruthit. Vaksinimi i rregullt bëhet çdo ditë në njësitë e vaksinimit në çdo komunë. Në kuadër të Programit të Zgjeruar të Imunizimit në Kosovë, prej vitesh është e përfshirë edhe vakcina kundër Fruthit, që jepet së bashku me vaksinën kundër Parotitit dhe Rubellës", thuhet në njoftimin për medie.

Fruthi është sëmundje virale shumë ngjitëse dhe e rëndë, që shkaktohet nga një virus i familjes Paramyxoviridae. Përhapet kryesisht përmes ajrit dhe spërklave dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Virusi infekton traktin respirator dhe pastaj përhapet në organizëm.

Simptomat

Shenja e parë e fruthit zakonisht është temperatura e lartë trupore, që zakonisht fillon rreth 10 deri më 12 ditë pas ekspozimit ndaj virusit dhe zgjat nga 4 deri 7 ditë. Shenja të tjera të sëmundjes janë rrjedhje nga hunda, kolla, sytë e skuqur e të përlotur dhe pika të vogla e të bardha në mukozën që e



mbështjell zgavrën e gojës. Pas disa ditësh paraqiten puçrrat, kryesisht në fytyrë dhe në pjesën e qafës.

Komplikimet

Komplikimet janë më të shpeshta te fëmijët në moshën nën 5 vjet ose tek të rriturit mbi 20 vjet. Si komplikime më të rënda janë: encefaliti (infeksion i cili shkakton ënjtje të trurit), verbërimi, diarre e rëndë e shoqëruar me dehidrim,

infeksionet e veshit dhe infeksionet e rënda të organeve të frymëmarrjes si, për shembull, pneumonia.

Kush është i rrezikuar?

Fëmijët e vegjël të pavaksinuar rrezikohen më së shumti nga fruthi dhe komplikimet e tij, madje edhe nga vdekja si pasojë e fruthit.

Trajtimi

Nuk ekziston trajtimi i posaçëm

antiviral kundër virusit të fruthit. Prandaj, mbrojtja më e mirë është vaksinimi që në fëmijëri kundër kësaj sëmundjeje.

Parandalimi

Vaksina kundër fruthit është mënyrë më e mirë për Parandalim dhe kjo vaksinë është e sigurt, efikase dhe në vendin tonë jepet falas. Përdoret tashmë e 50 vjet. Vaksinimi në Kosovë kundër fruthit, fillon tek fëmijët në

momentin që fëmija mbush 12 muaj dhe jepet si dozë e kombinuar me vaksinën kundër Shtave (Parotitit) dhe Rubellës. Që të sigurohet imunitet dhe që të parandalohet paraqitja e epidemive, rekomandohet marrja e dy dozave të vaksinës. Doza e dytë e kësaj vaccine (rivaksinimi) të kombinuar jepet tek fëmijët e moshës 6-7 vjeçe. Vakcina ka efekt të lartë që shkon deri në mbi 95 për qind mbrojtje për të vaksinuarit.

Therje me thikë në Mitrovicën e Veriut

MITROVICË, 3 MARS - Një therje me thikë ka ndodhur mbrëmjen e 2 marsit në Mitrovicën e Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe, ku dy qytetarë të nacionalitetit serb kanë mbetur të plagosur dhe ndodhen në Qendrën Spitalore në veri, njëri në gjendje më të rëndë.

Kështu tha për "Radion Evropa e Lirë" drejtori i

Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Besim Hoti. Ai tha se dorasi ka ikur por që, sipas tij, PK-ja ka informacione për të dhe tashmë është në proces të kërkimit të tij.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, i cili shkroi në rrjetin social "Facebook" se për këtë është njoftuar nga policia, tha se "njësitë relevante policore

tashmë kanë dyshime të bazuara mbi dorasin e këtij akti, i nacionalitetit serb, është pjesëtar i strukturave paralele kriminale të Serbisë. Njësitë policore do të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme në bazë të kompetencave që kanë në mënyrë që dorasi apo dorasit e këtij sulmi të sillen sa më parë para drejtësisë", ka shkruar Sveçla.



Çfarë e kërcënon sigurinë publike dhe kombëtare të Kosovës?

PRISHTINË, 3 MARS - Qytetarët e Kosovës vlerësojnë se rreziku kryesor për sigurinë kombëtare në vend vjen nga rritja e çmimeve të mallrave, ndjekur pas nga trafikimi i drogës, kriza energjetike dhe kriza ekonomike, tregojnë të dhënat e një raportit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

Ngjashëm, edhe në Shqipëri dhe Serbi, rritja e çmimeve të mallrave dhe kriza ekonomike shihen si rreziqe kryesore.

Dea Fetiu nga QKSS-ja thotë se shqetësimi për rritjen e çmimeve është kaq i theksuar për shkak të rreziqeve që mund të pasojnë. "Kjo mund të çojë në një krizë ekonomike dhe në një varfëri edhe më të madhe, e cila, pastaj, bashkë me papunësinë dhe disa rreziqe të tjera, bëhet shumë e rrezikshme për sigurinë kombëtare", thotë Fetiu për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova e ka përmbyllur vitin 2022 me normë mesatare të inflacionit mbi 12 për qind. Sipas anketave me

qytetarë, të bëra nga disa organizata joqeveritare, rritja e çmimeve të mallrave dhe kriza ekonomike janë rreziqet kryesore për sigurinë e tyre kombëtare. Sipas raportit të QKSS-së, rrezikshmëria më e ulët për sigurinë kombëtare në Kosovë vlerësohet të vijë nga pandemia Covid-19, nga ekstremizmi dhe terrorizmi i dhunshëm, si dhe nga ngrohja globale dhe ndotja e ambientit.

Për këtë anketë, QKSS-ja ka grumbulluar të dhëna nga 25 shtatori deri më 2 tetor të vitit 2022, kur janë intervistuar 1 136 familje. Këto të dhëna fillimisht janë publikuar në Barometrin e Sigurisë së Ballkanit Perëndimor, ku QKSS-ja bashkëpunon me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në Shqipëri dhe Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë në Serbi.

Sipas anketës, qytetarët në Kosovë dhe Shqipëri vlerësojnë se siguria personale dhe ajo e komunitetit

rrezikohen më së shumti nga migrimi i të rinjve dhe profesionistëve, ndërsa në Serbi nga përdorimi i drogës dhe varësia prej saj.

Nga anketat e bëra me qytetarë në Kosovë dhe Shqipëri, migrimi i të rinjve dhe profesionistëve shihet si rreziku kryesor për sigurinë publike, ndërsa në Serbi si rrezik i tillë përmendet përdorimi i drogës dhe varësia prej saj.

Në të tria vendet, qytetarët nuk ndihen shumë të kërcënuar nga sëmundja Covid-19, tregojnë të dhënat e anketës.

Shqetësimi më i madh për të është në Kosovë, ku 35 për qind e të anketuarve thonë se shëndeti i tyre rrezikohet nga sëmundja Covid-19.

Një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës - 46 për qind - beson se shëndeti publik nuk rrezikohet nga sëmundja Covid-19, tregon një hulumtim i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Sipas tij, 53 për qind e të anketuarve besojnë se

vaksinimi kundër sëmundjes ka pasur rezultat vetëm të pjesshëm ose fare.

Sipas të dhënave të publikuara më 1 mars nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), në vend janë 236 raste aktive me Covid-19.

Shifra është shumë më e ulët në krahasim me vitet e para të pandemisë, kur ka qenë disa mijëra.

Zyrtarja për informim në IKSHPK, Era Pireva, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se "qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm për rrezikun nga Covid-19" dhe se duhet të vazhdojnë t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve shtetërore.

Dhuna në familje është parë nga më pak se gjysma e të anketuarve në Kosovë, përkatësisht 45 për qind, si rrezik për sigurinë publike.

Vetëm 1 për qind e të anketuarve në Kosovë kanë thënë se përjetojnë personalisht dhunë në familje,

ndërsa 11 për qind kanë thënë se njohin persona që e kanë këtë problem.

Kushtet e këqija ekonomike shihen si shkak kryesor i dhunës në familje në Kosovë, tregon një anketë e bërë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Sipas të anketuarve, kushtet e këqija ekonomike janë shkak kryesor i dhunës në familje. Institucionet duhet të marrin masa për ngritjen e cilësisë së arsimit për ta luftuar këtë fenomen, thonë ata. Por, drejtori i Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë, Vebi Mujku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se perceptimi i qytetarëve është i gabuar.

Sipas tij, shkak të dhunës së tillë është më shpesh ngritja e standardit të jetesës sesa gjendja e rëndë ekonomike. "Numri i rasteve [të dhunës në familje] te familjet me asistencë sociale apo me probleme të mëdha ekonomike, është shumë i vogël", thotë Mujku, pa dhënë detaje. Sipas tij, faktorët kryesorë që çojnë në dhunë janë: përdorimi i substancave narkotike, tradhtia, shantazhi dhe rrjetet sociale.

Mujku thotë se, vit pas viti, është rritur numri i rasteve të dhunës në familje që raportohen në QPS.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, ofruar Radios Evropa e Lirë, gjatë vitit 2022 janë evidentuar 2.793 raste të dhunës në familje, prej të cilave mbi 80 për qind kanë qenë gra. Gjatë vitit 2021, ndërkaq, janë raportuar 2.456 raste dhe më 2020 - 2.069 raste.

Megjithëse numri i raportimeve për raste të dhunës në familje është në rritje, vetëm 2 për qind e të anketuarve nga QKSS-ja thonë se ndihen të pasigurt në shtëpitë e tyre - ndjeshëm më pak se përqindja në Serbi dhe Shqipëri.

Në të tria vendet, qytetarët ndihen më së paku të sigurt në shtet dhe në internet. Dea Fetiu, nga organizata QKSS, beson se qytetarët ndihen më pak të sigurt në këto dy sfera pasi që kanë më pak kontroll mbi to, sesa në shtëpitë dhe lagjet e tyre. Gjatë vitit të kaluar, disa uebfaqe të institucioneve në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, kanë qenë cak i sulmeve kibernetike.



Nënshkruhet marrëveshje mes MASHTI-t dhe UP-së për aktivitete të përbashkëta

PRISHTINË, 3 MARS - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" / Fakultetin e Edukimit, e cila bazohet në nevojën e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit profesional të mesimdhënësve, drejtorëve të shkollave dhe profesionistëve të tjerë arsimorë në Republikën e Kosovës.

Marrëveshja synon implementimin e aktiviteteve të përbashkëta në formën e

kombinimit të zhvillimit profesional të personelit të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe hulumtimit shkencor në fushat përkatëse për ta modeluar zhvillimin më koherent dhe të bazuar në dëshmi dhe për ta arritur efektin e reformës përmbytësore.

Nënshkruarit e marrëveshjes, ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci dhe rektori i UP-së, Qerim Qerimi, kanë theksuar rëndësinë që ka kjo marrëveshje e cila synon definimin dhe identifikimin e projekteve të përbashkëta për aplikim në

fonde të ndryshme të mekanizmave të Bashkimit Evropian me qëllim të avancimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional dhe hulumtimit brenda fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje.

Ministrja Nagavci tha se pikat që përfshin kjo marrëveshje janë të një rëndësie të veçantë për arsimin dhe hulumtimin shkencor, ndërsa theksoi gatishmërinë e saj dhe të MASHTI-t që me përkushtim t'i përmbushë përgjegjësitë dhe detyrat që ka marrë në këtë drejtim.



Mbi 27 mijë euro nga buxheti i shtetit për mëditjet e deputetëve gjatë vitit 2022

PRISHTINË, 3 MARS - Mbi 27 mijë euro kanë marrë mëditje për udhëtime jashtë Kosovës deputetët e Kuvendit. Deputetët e shumicës parlamentare kanë udhëtuar më së shumti jashtë vendit gjatë vitit 2022. Detyrë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pos pjesëmarrjes në seanca dhe

komisione, janë edhe udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Por, zakonisht për këto udhëtime paguan shteti, pos në rastet kur shpenzimet mund të mbulohen nga organizatorët. Sipas një kërkesë për qasje në dokumente publike, "RTV Dukagjinit" i janë dhënë shpenzimet nga Kuvendi

dhe në këto udhëtime deputetët kanë marrë mëditje mbi 27 mijë euro për vitin 2022. Për ShBA, Çeki, Shqipëri, Bruksel e shumë shtete të tjera më së shumti mëditje u kanë takuar deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët për këtë kategori kanë marrë 10 079 euro.



Rizvanolli përfaqëson Kosovën në Forumin për Klimë dhe Energji në Zagreb

ZAGREB, 3 MARS - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, po përfaqëson Republikën e Kosovës në Forumin e Partnershipit për Bashkëpunim Transatlantik për Klimë dhe Energji (P-TECC) që po mbahet në Zagreb të Kroacisë.

Ministrja Rizvanolli po merr pjesë me ftesë të Departamentit të Energjisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ishte pjesë e panelit të efikasitetit dhe energjisë së ripërtërishme në kuadër të forumit, ku folës ishte edhe Peter Szijjarto, ministër i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë, Marc Lafrance, përfaqësues i Departamentit Amerikan për Energji dhe Jubo Turashvili, përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Gjeorgjisë.

Gjatë fjalës së saj ministrja



Rizvanolli ka ndarë përvojën e suksesshme të Kosovës në përballje me krizën energjetike

dhe të gjitha masat që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për t'i ndihmuar qytetarët dhe

bizneset si dhe për ta rritur efikasitetin, si subvencionimi i pajisjeve eficiente, subven-

cionimi i kursimit dhe fushatat vetëdijësuese.

Ministrja Rizvanolli, po ashtu, theksoi se gjatë muajve në vijim do ta thellojnë ndarjen e përvojave dhe bashkëpunimin me Departamentin e Energjisë së ShBA-së në këtë fushë.

Në vitin 2021 ministrja Rizvanolli ka përfaqësuar Kosovën për herë të parë në këtë forum, i cili është mbajtur në Varshavë.

P-TECC është e fokusuar në bashkëpunimin teknik në disa fusha, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe shpërndarjen e energjisë së pastër, përfshirë sektorët e energjisë së rinovueshme, energjisë bërthamore, po ashtu mbështet praktikën më të mirë të sigurisë kibernetike të energjisë dhe promovimin e investimeve të reja kapitale në infrastrukturën kryesore të energjisë.

Shyqyri Haxha lirohet nga akuza për lidhje të kontratës së dëmshme sa ishte kryeshef i PTK-së



PRISHTINË, 3 MARS - Shyqyri Haxha është liruar nga akuza se kishte lidhur kontratë të dëmshme sa ishte kryeshef i Postës dhe Telekomit të Kosovës. Aktgjykimi liruës është shpallur të premtën nga gjyqtari Sabit Sadikaj në Gjykatën Themelore të Prishtinës. "Gjykata në këtë përfundim ka ardhur pasi që duke u bazuar në Ligjin për Prokurim Publik me nr. 2003/17 i vitit 2008, i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, me nënshkrimin nga

zyrtari i prokurimit të PTK-së dhe përfaqësuesi i 'Amdocs', kontrata hynte në fuqi, ndërsa nënshkrimi nga kryeshefi Shyqyri Haxha nuk kishte kurrfarë detyrimi për PTK-në". Pala e dëmtuar, Posta dhe Telekomit i Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në konteste të rregullta juridiko-civile. Pas pranimit të aktgjykimit në formë të shkruar, palët kanë të drejtë ankese brenda 30 ditë përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit.

Më 10 mars mbahet ankandi i dytë i letrave me vlerë prej 30 milionë eurosh


PRISHTINË, 3 MARS - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 10 mars 2023 do të mbahet ankandi i dytë për vitin 2023. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 30 milionë

eurosh. Investimi në Obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen dy vjet

dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. "Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftimin për medie.



Autori i ndërfutur



David LODGE

Me një pikë të vetme boje për pasqyrim, magjistari egjiptian u mor t'i zbulonte çdo vizitori të rastit vegjime largpamëse të së shkuarës. Këtë do ta bëj edhe unë për ju, lexues. Me këtë pikë boje në fund të stilolapsit, do t'jua tregoj punishten e madhe të Jonathan Burgeit, marangoz dhe ndërtues në fshatin Hayslope, ashtu siç erdhi, në vitin e Zotit tonë, më 18 qershor 1799.

GEORGE ELIOT, Adam Bede (1859)

Margaretës – shpresoj se kjo nuk do t'ia kthejë lexuesin kundër – stacioni i King Crossit përherë i ngjasonte Pafundësisë. Pozicioni i tij – pak i tërhequr pas shkëlqimeve të lehta të Saint Panerasit – nënkuptonte materializmin e jetës. Ato dy harqe të mëdha, pa ngjyrë, mospërfillëse, që mbanin ndërmjet një orë neveritëse, ishin porta të pranueshme për një aventurë të përshkuese, vendosja e të cilave mund të ishte e begatë, por sigurisht nuk do të shprehej në gjuhën e zakonshme të përparimit. Nëse ju duket qesharake, mbajeni në mend se këtë nuk po jua rrëfen Margareta; dhe më lejoni nxitimthi të shtoj se ato kishin mjaft kohë për ta kapur trenin; dhe se zonja Munt zuri vend të rehatshëm përballë motorit, por jo shumë afër tij; dhe Margareta, pas kthimit në pallatin Wickham, mori telegramin e mëposhtëm:

Gjithkund. Do t'ia shiroja zëri i madhëzë kisha shkruar kurrë. Mos i trego askujt. Helena Por, halla Juley u zhduk, iku pa kthim dhe asnjë fuqi në tokë nuk mund ta ndalte.

M. FORSTER, Fundi i Howardi (1910)

MËNYRA MË E THJESHTË për të rrëfyer storje është me anë të zërit të rrëfimitarit i cili mund të jetë zëri anonim i përrallës popullore ("Një herë e një kohë, na ishte një princeshë e bukur") ose zëri i bardit epik (p.sh., i Virgjilit: "Unë armët po këndoj dhe atë burrin^[1]") ose zëri autorial besnik, shoqëruar, moralizues i veprave klasike që nga Henry Fieldingu te George Elioti.

Në hyrje të Adam Bedes përmes trukut të pastër retorik me pikën e bojës, që është edhe pasqyrë edhe medium, George Eliot e shndërroi aktin e të shkruarit në akt të të folurit. Ky është adresim i drejtpërdrejtë, por edhe intim ndaj lexuesit, që të na tërheqë "përtej pragut" të romanit dhe, tekstualisht, përtej pragut të punishtes të Jonathan Burgeit. Me anë të nënkuptimit, ajo kundërvë rrëfimin e hollë e të saktë historik me zbulimet e dyshimta të magjisë dhe besëtytnive. Copëzat e informacionit rreth teknikave të magjistarëve egjiptianë nuk kanë tjetër funksion narrativ, por nuk gjenden aty pa ndonjë interes. Në fund të fundit, ne lexojmë fikcione jo vetëm për storjen, por edhe për t'i zgjeruar njohuritë dhe kuptimin tonë për botën dhe, në këtë rrafsh, metoda e rrëfimit autorial është e përshtatshme të përfshijë çdolloj njohurie enciklopedike dhe urtësie proverbiale.

Sidoqoftë, rreth fundit të shekullit të 19-të, rreth fundit të shekullit të 20-të, rreth fundit të shekullit të 21-të, rreth fundit të shekullit të 22-të, rreth fundit të shekullit të 23-të, rreth fundit të shekullit të 24-të, rreth fundit të shekullit të 25-të, rreth fundit të shekullit të 26-të, rreth fundit të shekullit të 27-të, rreth fundit të shekullit të 28-të, rreth fundit të shekullit të 29-të, rreth fundit të shekullit të 30-të, rreth fundit të shekullit të 31-të, rreth fundit të shekullit të 32-të, rreth fundit të shekullit të 33-të, rreth fundit të shekullit të 34-të, rreth fundit të shekullit të 35-të, rreth fundit të shekullit të 36-të, rreth fundit të shekullit të 37-të, rreth fundit të shekullit të 38-të, rreth fundit të shekullit të 39-të, rreth fundit të shekullit të 40-të, rreth fundit të shekullit të 41-të, rreth fundit të shekullit të 42-të, rreth fundit të shekullit të 43-të, rreth fundit të shekullit të 44-të, rreth fundit të shekullit të 45-të, rreth fundit të shekullit të 46-të, rreth fundit të shekullit të 47-të, rreth fundit të shekullit të 48-të, rreth fundit të shekullit të 49-të, rreth fundit të shekullit të 50-të, rreth fundit të shekullit të 51-të, rreth fundit të shekullit të 52-të, rreth fundit të shekullit të 53-të, rreth fundit të shekullit të 54-të, rreth fundit të shekullit të 55-të, rreth fundit të shekullit të 56-të, rreth fundit të shekullit të 57-të, rreth fundit të shekullit të 58-të, rreth fundit të shekullit të 59-të, rreth fundit të shekullit të 60-të, rreth fundit të shekullit të 61-të, rreth fundit të shekullit të 62-të, rreth fundit të shekullit të 63-të, rreth fundit të shekullit të 64-të, rreth fundit të shekullit të 65-të, rreth fundit të shekullit të 66-të, rreth fundit të shekullit të 67-të, rreth fundit të shekullit të 68-të, rreth fundit të shekullit të 69-të, rreth fundit të shekullit të 70-të, rreth fundit të shekullit të 71-të, rreth fundit të shekullit të 72-të, rreth fundit të shekullit të 73-të, rreth fundit të shekullit të 74-të, rreth fundit të shekullit të 75-të, rreth fundit të shekullit të 76-të, rreth fundit të shekullit të 77-të, rreth fundit të shekullit të 78-të, rreth fundit të shekullit të 79-të, rreth fundit të shekullit të 80-të, rreth fundit të shekullit të 81-të, rreth fundit të shekullit të 82-të, rreth fundit të shekullit të 83-të, rreth fundit të shekullit të 84-të, rreth fundit të shekullit të 85-të, rreth fundit të shekullit të 86-të, rreth fundit të shekullit të 87-të, rreth fundit të shekullit të 88-të, rreth fundit të shekullit të 89-të, rreth fundit të shekullit të 90-të, rreth fundit të shekullit të 91-të, rreth fundit të shekullit të 92-të, rreth fundit të shekullit të 93-të, rreth fundit të shekullit të 94-të, rreth fundit të shekullit të 95-të, rreth fundit të shekullit të 96-të, rreth fundit të shekullit të 97-të, rreth fundit të shekullit të 98-të, rreth fundit të shekullit të 99-të, rreth fundit të shekullit të 100-të.

Ai, gjithashtu, pretendon një lloj autoriteti, një gjithëdije si – Zot, gjë që epoka jonë skeptike dhe relativiste heziton t'ia pranojë ndokujt. Fiksioni modern tentoi ta ndrydhë apo ta eliminojë zërin autorial, duke i paraqitur veprimet nëpërmjet ndërrijes së personazheve apo duke ua lënë atyre detyrën e rrëfimit. Kur zërin e ndërfutur autorial e hasim në veprat moderne, ai zakonisht përdoret me një ndërrijë të caktuar ironike, si te fragmenti te Fundi i Howardi. Ky fragment përmbyll kapitullin e dytë, ku Margaret Schlegel nga Bloomsburyite, pasi ka dëgjuar se motra e saj Helena ka rënë në dashuri me djalin e vogël të kapitenit të ri e të pasur të industrisë, Henry Wilcox, dërgon hallën e saj (zonjën Munt) ta hetojë rastin.

Fundi i Howardi është roman mbi gjendjen e Anglisë dhe ndjesinë e vendit si tërësi organike, me një të kaluar frymëzuese shpirtërore, në thelb agrare dhe një të ardhme problematike nën hijen e tregtisë dhe industrisë dhe kjo u jep rëndësi përfaqësuese personazheve dhe marrëdhënieve të tyre. Kjo temë arrin kulmin vizionar në kapitullin 19 ku, nga këndvështrimi i lartë i kodrave të Purbeckut, autori shtron pyetje nëse Anglia iu përket atyre që krijuan pasurinë dhe fuqinë e saj apo "atyre që... disi e panë, e panë gjithë ishullin përmjherë, të shtrirë si xhevahir në detin e argjendte, duke lundruar si anije shpirttrash, me gjithë flotën e guximshme të botës që e shoqëron në përjetësi". Edhe autori edhe Margareta i përkasin shoqërisë vizionare. Pafundësia që Margareta e lidh me stacionin e Kings Crossit është e barabartë me përjetësinë drejt së

cilës lundron anija e Anglisë, ndërsa materializmi dhe përparimi mbi të cilat bën vërejtje negative për Kings Crossin, i përkasin botës së Wilcoxesit. Njëzëshmëria e sentimentit midis autorit dhe heroinës vërehet në stil: vetëm kalimi në kohën e shkuar ("n'nkupton "ishinporta të p'rshtatshme" dallon mendimin e Margaretës, gramatikisht nga zëri autorial. Forsteri haptazi, disa mund të thonë së tepërmi, mbron heroinën e tij.

Frazat: "Margaretës – shpresoj se kjo nuk do t'ia kthejë lexuesin kundër"... "mbajeni në mend se këtë nuk po jua rrëfen Margareta", janë lëvizje të rrezikshme që i afrohen efektit që Erving Goffman e quan "thyerje e kornizës" – e kjo ndodh kur shkelet një parim ose një konvencë që rregullon një lloj të caktuar përvoje. Këto fraza nxjerrin në pah atë që iluzioni realist kërkon ta ndrydhë ose ta frenojë – dijeninë se po lexojmë një roman rreth personazheve dhe veprimeve të trilluara.

Ky mjet favorizohet shumë nga shkrimtarët postmodernë të cilët mohojnë besimin naiv në realizmin tradicional duke ekspozuar të palarat e krijimeve fiktive. Krahasoni, për shembull, këtë ndërfutje autoriale befasuese në mes të librit I mirë si (1980) të Joseph Hellerit:

Edhe një herë Goldi u zu duke u përgatitur të drekojë me dikë – Spotty Weinrockun – dhe më shkrepri në çast se ai po kalonte shumë kohë në këtë libër duke ngrënë dhe duke folur. Nuk kisha çfarë të bëja më shumë me të. E fusja në shtrat me Andrean, ndërsa gran e fëmijët praktikisht ia mbaja në sfond... Pa dyshim, ai së shpejti

do të takojë një mësuese me katër fëmijë, në të cilën do të dashurohet marrëzisht dhe unë do të vazhdoj premtimin torturues, që ta bëj të parin hebre sekretar të shtetit, premtim që nuk e kam ndër mend ta mbaj.


Forsteri nuk e nënçmon kaq radikalisht iluzionin e jetës të krijuar nga storja e tij. Ai shtyn interesimin tonë drejt personazheve dhe fateve të tyre duke iu referuar atyre si të ishin njerëz të vërtetë. Pra, çfarë përpiqet të arrijë me tërheqjen e vëmendjes te hendeku midis përvojës së Margaretës dhe rrëfimit të tij? Kujtoj se, duke bërë referenca argëtuese, vetëpërçmuese ndaj funksionit retorik, atij i lejohet, si të thuash, të kënaqet me ato prova autoriale elokvente rreth historisë dhe metafizikës (si vizioni i Anglisë nga kodrat e Purbeckut) që i shpërmdan në roman dhe i konsideron thelbësore për temën. Humori urban është mënyrë efektive ta devijojë dhe ta çarmatosë reagimin e mundshëm "Mos më thuaj?" të lexuesit, që e kërkon ky lloj përgjithësimi autorial. Forsteri, gjithashtu, tallet me ndërprerjen e momentumit narrativ që fragmentet e tilla e sjellin natyrshëm, duke "nxituar" me keqardhje të na kthejë në storje dhe duke e përfunduar kapitullin me një efekt të shkëlqyer suspanse.

Por suspansa është temë më vete.

P'rktheu nga anglishtja: Meli Krasniqi
Marrë nga numri 16 i revistës "Akademia". Të drejtat e botimit, "Armagedoni"

[1] Eneida Virgjili, Gjon Buzuku Prishtinë, 2006, përktheu Henrik Lacaj.

Si shfrytëzohet një komb



George ORWELL

Pas trazirave të fundit në fillim të shfrytëzohen. Ka kemi kërkuar kontribuesit kallaj, tungsten, nefrit dhe rubin, zoti. E. A. Blair, raportuesit dhe këto janë materialet më të cilit, për gjendjen e vërtetë minerale. Në këtë punëtorit britanik, janë moment prodhon pesë për qind kësaj gazetë, të na tregojë të tjerës në botë dhe rezervat e për gjendjen e pakënaqësisë nuk bëhet fjalë të shterojnë. Për shfrytëzimin në madh i pasurisë prej disa vjetësh dhe që po dhe ajo që ushqen midis kërcënimit të hapet në tërësi të Kinës angleze. Zoti E. A. çin dhe popullsisë – janë arat me cili ka jetuar për disa vjetësh. Orizi rritet kudo në pellgun Burma, ka shkruar artikullin riravaddy, i cili rrjedh nëpër mëposhtëm interesant për Birmani nga veriu në jug.

Në jug, në deltën e madhe ku Perandoria Britanike për të shfrytëzuar kolonitë e saj zhvendosur çdo vit, toka është aziatike. Progras Civique jashtëzakonisht pjellore. Të Birmania shtrihet midis Indisë dhe Kinës. Në aspektin etnologjik i përket Indo-Kinës. Është tri herë më e madhe se Anglia dhe Uellsit, me një popullsi rreth katërmëdhjetë milionësh, nga të cilët rreth nëntë milionë janë birmanezë. Pjesa tjetër përbëhet nga fise të panumërta mongole që kanë emigruar në periudha të ndryshme nga stepat e Azisë Qendrore dhe nga indianët që kanë ardhur që prej pushtimit anglez. Birmanezët janë budistë; anëtarët e fisit adhurojnë perëndi të ndryshme pagane. Për të qenë në gjendje të flasësh në gjuhën e tyre me njerëzit me origjinë kaq të ndryshme që jetojnë në Birmani, do t'ju duhet të dini njëqind e njëzet gjuhë dhe dialekte të ndryshme.

Ky vend, popullsia e të cilit është një e dhjeta më e dendur se ajo e Anglisë, është një nga më të pasurit në botë. Ka shumë burime natyrore të cilat sapa

operacion u përsërit më 1852 dhe më në fund më 1882 flamuri britanik u valëvit në gati të gjithë vendin. Disa rrethe malore në veri, të banuara nga fise të vogla të egra, u shpëtuan deri vonë kthetrave të britanikëve, por ka gjithnjë e më shumë gjasa që ato të kenë të njëjtin fat si pjesa tjetër e vendit falë procesit të njohur në mënyrë eufemiste si “depërtim paqësor”, që do të thotë, me anglishte të thjeshtë, “aneksim paqësor”.

Në këtë artikull nuk kërkoj të lëvdoj apo fajësoj këtë manifestim të imperializmit britanik; le të theksojmë vetëm se është një rezultat logjik i çdo politike imperialiste. Do të jetë shumë më e dobishme të shqyrtohen anët e mira dhe të këqija të administratës britanike në Birmani nga pikëpamja ekonomike dhe politike.

Le t'i drejtohem si pari politikës. Qeveria e të gjitha provincave indiane nën kontrollin e Perandorisë Britanike është domosdoshmërisht despotike, sepse vetëm kërcënim i forcës mund të nënshtrojë një popullsi prej disa milionë nënshtetasish. Por ky despotizëm është i fshehur. Ajo fshihet pas maskës së demokracisë. Maksima e madhe e anglezëve në qeverisjen e një race orientale është “mos i kërko kurrë të bëjë diçka një evropian kur mund ta bëjë një orientali”. Me fjalë të tjera, pushteti suprem mbetet tek autoritetet britanike, por nëpunësit civilë të rangut të ulët që duhet të kryejnë administrimin e përditshëm dhe

që duhet të vijnë në kontakt me njerëzit gjatë kryerjes së detyrave të tyre, rekrutohen në nivel lokal.

Në Birmani, për shembull, magistratët e klasës së ulët, të gjithë policët deri në gradën e inspektorit, punonjësit e shërbimit postar, nëpunësit e qeverisë, pleqtë e fshatit etj. janë birmanezë. Kohët e fundit, për ta qetësuar opinionin publik dhe për t'i dhënë fund agjitacionit nacionalist që kishte filluar të shkaktohej shqetësim, u vendos që të pranohej kandidatura e vendasve të arsimuar për disa poste të rëndësishme. Sistemi i punësimit të vendasve si nëpunës civilë ka tri përparësi: Së pari, vendasit pranojnë paga më të ulëta se evropianët. Së dyti, ata kanë një ide më të mirë se si funksionon mendja e bashkatdhetarëve të tyre dhe kjo i ndihmon të zgjidhin më lehtë mosmarrëveshjet ligjore.

Së treti, është përparësi ta tregojnë besnikërinë e tyre ndaj një qeverie që u siguron jetesën. Dhe kështu paqja ruhet duke siguruar bashkëpunimin e ngushtë të klasave të arsimuara ose gjysmë të arsimuara, ku pakënaqësia mund të krijojë udhëheqës rebelë. Megjithatë britanikët e kontrollojnë vendin. Sigurisht, Birmania, si çdo provincë indiane, ka një parlament – gjithmonë shfaqje në dukje e kinse demokracisë – por në realitet parlamenti ka shumë pak pushtet.

Asgjë me ndonjë pasojë nuk është në juridiksionin e saj.

Shumica e anëtarëve janë kukulla të qeverisë, e cila u rri mbi kokë për t'i përdorur për të kapur në kohë çdo projektligj që duket i parakohshëm. Përveç kësaj, çdo provincë ka një guvernator të emëruar nga anglezët, i cili ka në dispozicion të drejtën e vetos po aq absolute sa ajo e presidentit të Shteteve të Bashkuara për të kundërshtuar çdo propozim që nuk i pëlqen. Megjithatë, megjithëse qeveria britanike është, siç kemi treguar, në thelb despotike, ajo nuk është aspak jopopullore.

Anglezët po ndërtojnë rrugë dhe kanale – për interesin e tyre, sigurisht, por birmanezët përfitojnë prej tyre – ata ndërtojnë spitale, hapin shkolla dhe kujdesen për ruajtjen e rendit dhe ligjit. Dhe në fund të fundit, birmanezët janë thjesht fshatarë që merren me kultivimin e tokës. Ata nuk e kanë arritur ende atë fazë të zhvillimit intelektual që i bën nacionalistë. Fshati është universi i tyre dhe për sa kohë lihen të qetë për t'i kultivuar arat, nuk u intereson nëse zotërinjtë e tyre janë të zi apo të bardhë.

Një dëshmi e kësaj apatie politike nga ana e popullit të Birmanisë është fakti se të vetmet forca ushtarake britanike në vend janë dy batalione këmbësorie angleze, rreth dhjetë batalione këmbësorie indiane dhe policia me kuaj. Kështu, dymbëdhjetë mijë burra të armatosur, kryesisht indianë, mjaftojnë për të nënshtuar një popullsi katërmëdhjetëmilion-

është. Armiqtë më të rrezikshëm të qeverisë janë të rinjtë e klasave të arsimuara. Nëse këto klasa do të ishin më të shumta dhe do të ishin vërtetë të arsimuara, ndoshta do të mund ta ngrinin flamurin revolucionar. Por nuk janë.

Arsyeja është së pari se, siç thashë, shumica e birmanezëve janë fshatarë.

Së dyti, qeveria britanike përpjet t'u japë njerëzve vetëm udhëzime të përmbledhura, të cilat janë thujse të padobishme, thjesht të mjaftueshme për të pasur korrierë, shërbëtorë civilë të shkallës së ulët, nëpunës të vegjël të avokatëve dhe punëtorë të tjerë krahu. Tregohet kujdes për ta shmangur pajisjen e tyre me aftësi teknike dhe njohuri për industrinë. Ky rregull, i respektuar në të gjithë vendin, synon ta pengojë Indinë të bëhet vend industrial i aftë për të konkurruar me Anglinë. Është e vërtetë të thuhet se në përgjithësi çdo birmanez me të vërtetë i arsimuar është shkolluar në Angli dhe, si rrjedhim, i përket klasës së vogël të të pasurve. Pra, meqenëse nuk ka klasa të arsimuara, opinion publik që mund të nxisë rebelim kundër Anglisë, nuk ekziston.

Le ta shqyrtojmë tani çështjen ekonomike. Edhe këtu birmanezët në përgjithësi janë shumë të paditur për të kuptuar qartë mënyrën se si trajtohen dhe, si rezultat, shumë të paditur për ta shfaqur pakënaqësinë më të vogël. Përveç kësaj, për momentin nuk kanë pësuar shumë dëm ekonomik. Është e vërtetë që britanikët morën në zotërim minierat dhe pusët e naftës. Është e vërtetë që ata kontrollojnë prodhimin e drurit. Është e vërtetë që lloj-lloj ndërmjetësish, tregtarësh, eksportuesish, kanë bërë pasuri

kolosale nga orizi pa prodhuesin – që është fshatari – duke ia marrë atij. Është gjithashtu e vërtetë që tregtarët e pasuruar shpejt që e kanë vënë pasurinë prej orizit, benzinës etj., nuk po kontribuojnë ashtu siç duhet në mirëqenien e vendit dhe se paratë e tyre, në vend se të rritin të ardhurat lokale në formën e taksave, dërgohen jashtë shtetit për t'u shpenzuar në Angli. Nëse jemi të sigurtë, duhet të themi se është e vërtetë që britanikët po grabisin dhe plaçkitin Birmaninë pa pikë turpi. Por duhet të theksojmë se birmanezët vështirë se e vënë re për momentin. Vendi i tyre është aq i pasur, popullsia e tyre aq e shpërndarë, nevojat e tyre, si ato të të gjithë orientaleve, aq të vogla sa nuk janë të vetëdijshëm se po shfrytëzohen.

Fshatari që kultivon ngastrën e tij të tokës jeton pak a shumë siç bënin paraardhësit e tij në kohën e Marko Polos. Nëse dëshiron mund të blejë tokë të virgjër me një çmim të arsyeshëm. Nuk diskutohet që jetesa e tij është e vështirë, por në përgjithësi nuk e vret mendjen shumë për këtë. Uria dhe papunësia janë fjalë të pakuptimta për të. Ka punë dhe ushqim për të gjithë. Pse të shqetësosh kot? Por, dhe kjo është pika e rëndësishme, birmanezët do të fillojnë të vuajnë kur një pjesë e madhe e pasurisë së vendit të tyre do të jetë shfrytëzuar. Edhe pse Birmania është zhvilluar deri në një masë që nga koha e luftës, tashmë fshatari atje është më i varfër se njëzet vjet më parë. Ai ka filluar ta ndiejë peshën e taksimit të tokës, për të cilën nuk kompensohet nga rritja e rendimentit të të korrave.

Pagat e punëtorëve nuk janë rritur bashkë me koston e jetesës. Arsyeja është se qeveria

britanike ka lejuar hyrjen e lirë në Birmani për hordhitë e vërteta të indianëve, të cilët, të ardhur nga një vend ku po vdisnin nga uria në kuptimin e vërtetë të fjalës, punojnë për asgjë dhe, si rrjedhim, janë rivalë të frikshëm për birmanezët.

Shtojni kësaj rritjen e shpejtë të rritjes së popullsisë – në regjistrimin e fundit popullsia pati rritje prej dhjetë milionë në dhjetë vjet – është e lehtë të kuptohet se herët a vonë, siç ndodh në të gjitha vendet e mbipopulluara, birmanezët do të shpronësohen nga tokat, të katandisur në një gjendje gjysmë skllavërie në shërbim të kapitalizmit, dhe do të duhet ta durojnë papunësinë. Më pas ata do të zbulojnë atë që vështirë se dyshojnë sot, se pusët e naftës, minierat, industria e mullirit, shitja dhe kultivimi i orizit kontrollohen të gjitha nga britanikët. Ata, gjithashtu, do ta kuptojnë paaftësinë e tyre në industri në një botë ku mbizotëron industria.

Politika britanike në Birmani është e njëjtë si në Indi. Në aspektin industrial India u mbajt qëllimisht e zhytur në padije. Ajo prodhon vetëm gjërat e nevojshme, të bëra me dorë. Indianët ishin të paaftë, për shembull, të prodhonin një motor-makinë, një pushkë, një orë, një llambë elektrike etj. Ata ishin të paaftë për të ndërtuar ose për të lundruar një anije detare. Në të njëjtën kohë kanë mësuar që në marrëdhëniet e tyre me perëndimorët varen nga disa artikuj që prodhohen me makinë. Kështu, produktet e fabrikave angleze gjejnë një treg të rëndësishëm në një vend të paaftë për t'i prodhuar ato vetë. Konkurrenca e huaj pengohet nga një barrierë e paka-

përcyeshme e tarifave ndaluese doganore. Kështu pronarët e fabrikave angleze, pa asgjë për t'u frikësuar, kontrollojnë në mënyrë absolute tregjet dhe korrrin fitime tepër të larta. Thamë se birmanezët nuk kanë vuajtur ende shumë, kjo sepse kanë mbetur në tërësi një komb bujqësor. Megjithatë, për ta, si për të gjithë orientalët, kontakti me evropianët ka krijuar kërkesën e panjohur për etërit e tyre për produktet e industrisë moderne. Si rezultat, britanikët po vjedhin nga Birmania në dy mënyra: Në radhë të parë po plaçkitin burimet natyrore; së dyti, po i japin vetes të drejtën ekskluzive për t'i shitur këtu produktet e prodhuara që i nevojiten tani. Dhe birmanezët po futen në sistemin e kapitalizmit industrial, pa asnjë shpresë për t'u bërë vetë industrialistë kapitalistë.

Për më tepër, birmanezët, si të gjithë popujt e tjerë të Indisë, mbeten nën sundimin e Perandorisë Britanike për arsye thjesht ushtarake. Sepse ata në fakt nuk janë në gjendje të ndërtojnë anije, të prodhojnë armë ose ndonjë armë tjetër të nevojshme për luftën moderne dhe, siç janë gjërat tani, nëse anglezët do të hiqnin dorë nga India, kjo do të rezultonte vetëm në një ndryshim të padronit. Vendi thjesht do të pushtohej dhe shfrytëzohej nga ndonjë Fuqi tjetër. Dominimi britanik në Indi mbështetet në thelb në shkëmbimin e mbrojtjes ushtarake me një monopol tregtar por, siç jemi përpjekur të tregojmë, pazari është në përparësinë e anglezëve, kontrolli i të cilëve shtrihet në çdo fushë.

Për ta përmbledhur, nëse Birmania nxjerr ndonjë përfitim të rastësishëm nga anglezët, ajo duhet të paguajë

shtrenjtë për këtë. Deri tani anglezët janë përmbajtur nga shtypja e tepërt e popullit vendas, sepse nuk ka pasur nevojë. Birmanezët janë ende në fillim të një periudhe tranzicioni që do t'i shndërrojë nga fshatarë bujqësorë në punëtorë në shërbim të industrive prodhuese. Gjendja e tyre mund të krahasohet me atë të çdo populli të Evropës së shekullit të tetëmbëdhjetë, përveç faktit se kapitali, materialet e ndërtimit, njohuritë dhe fuqia e nevojshme për tregtinë dhe industrinë e tyre u përkasin ekskluzivisht të huajve. Pra, ata janë nën mbrojtjen e një despotizmi që i mbron për qëllimet e veta, por që do t'i braktiste pa mëdyshje nëse ata nuk do të ishin më të dobishëm. Marrëdhënia e tyre me Perandorinë Britanike është ajo e skllavit me padronin. A është padroni i mirë apo i keq? Nuk është kjo çështja; le të themi thjesht se kontrolli i tij është despotik dhe, për ta thënë më qartë, për interesa personale. Edhe pse birmanezët nuk kanë pasur shumë arsye për t'u ankuar deri më tani, do të vijë dita kur pasuritë e vendit të tyre do të jenë të pamjaftueshme për një popullsi që po rritet vazhdimisht. Atëherë ata do të jenë në gjendje të vlerësojnë se si kapitalizmi e tregon mirënjohjen ndaj atyre të cilëve u detyrohet ekzistenca e tij.

A. Blair, *Le Progrès Civique*, 4 maj 1929. Përkthyer në anglisht nga Janet Percival dhe Ian Willison.

Përktheu: Granit ZELA. Të drejtat e botimit dhe të përkthimit, revista "Akademia".

[1] Artikulli është botuar në gazetën franceze *Le Progrès Civique* më 4 maj 1929. (Shënim i përkthyesit).



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova arrin fitore me shumë peshë ndaj Italisë

PRISHTINË, 3 MARS - Përfaqësuesja U17 e Kosovës në hendboll ka konfirmuar të premtën arritjen që e përjetoi gjatë Kampionatit Mesdhetar në Greqi. Vashat "dardane" luajtën ndeshje shumë të mirë dhe fituan ndaj Italisë me rezultat bindës 18:13.

Vashat e Kosovës e fituan periudhën e parë me rezultat 8:4. Periudha e dytë u takoi italianeve, ndërsa në periudhën e tretë sërish më të mira ishin njomaket tona, 5:3. Të kujtojmë që ditë më parë jemi mposhtur nga Italia, por loja e Kosovës U17

është përmirësuar vazhdimisht dhe si rezultat erdhi fitorja ndaj Italisë. Sot (e shtunë) Kosova U17 e luan ndeshjen e fundit në Mesdhetarin në Greqi. Përvoja në këtë garë do t'i shërbejë shumë kësaj gjenerate.



Thaqi: Pres fitore ndaj Llapit që ta vazhdojmë rrugën drejt titullit

Skuadra e Dritës, pas humbjes nga Ferizaj në ndeshjen e kaluar, është përgatitur që t'u rikthehet fitoreve në ndeshjen e radhës ndaj Llapit. "Shpresojmë në fitore që të vazhdojmë rrugën drejt titullit", ka thënë Arsim Thaqi, trajner i skuadrës gjilanase

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 MARS - Trajneri i Dritës, Arsim Thaqi, një ditë para derbit kundër Llapit, ka thënë në konferencën për medie se synim i Dritës është fitorja dhe rrugëtimi drejt titullit të kampionit në Superligë. Thaqi me këtë rast ka konfirmuar se në këtë ndeshje Dritës i mungon Kastriot Selmani. "Në sezonin pranveror nuk ka favorit. Të gjitha ekipet marrin masat, andaj stinori pranveror është më

i vështirë. Kemi ende shumë kohë deri në përfundim. Humbja e fundit nuk është pritur, mirëpo futbollit është ky. Në tri ndeshjet e radhës kundër Llapit, Gjilanit dhe Ballkanit, nëse gjërat shkojnë mirë, Drita është në rrugën e duhur. Kam pasur një javë të plotë të punoj me lojtarët. Nuk ka qenë lehtë pas humbjes dëshpëruese për ekipin, megjithatë janë lojtarë profesionistë. Përveç Kastriot Selmanit, i cili është i suspenduar, pjesa tjetër e lojtarëve janë gati. Shpresojmë



në fitore që ta vazhdojmë rrugën drejt titullit", ka thënë Thaqi. Në konferencën për medie, krahas trajnerit Thaqi, ishte edhe futbollisti Rron Broja, i cili ka thënë se Drita synon t'u rikthehet fitoreve. "Gjatë gjithë javës jemi munduar t'i përmirësojmë gabimet që i kemi

bërë këto ndeshje dhe të përmirësohemi sa më shumë. Ndeshja e nesërme na jep mundësi t'i përmirësojmë gabimet dhe të rikthehemi te fitorja. Me shumë punë nesër dhe me një agresivitet të madh t'i marrim tri pikë dhe t'i vazhdojmë synimet tona", ka

deklaruar Broja. Aktualisht Drita zë vendin e dytë në tabelë me 44 pikë, katër më pak se Ballkani që është lider, në anën tjetër Llapi renditet në pozitën e pestë me 29 pikë të grumbulluara. Sot (e shtunë) krahas kësaj ndeshjeje do të zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera, ku takohen Dukagjini-Gjilani dhe Drenica-Ferizaj.

SUPERLIGA - Java 23

Të shtunën takohen:
Drita - Llapi
Dukagjini - Gjilani
Drenica - Ferizaj

Të dielën takohen:

Prishtina - Ballkani
Trepça '89 - Malisheva

Dy ndeshje sot, dy nesër në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 3 MARS - Takime interesante priten në xhiron e 24-t të Prince Caffè Superligës. Trepça - Rahoveci është përsëritja e gjysmëfinaleve të Kupës, ku mitrovicasit shpresojnë të vazhdojnë me fitore, ndërsa rahovecasit janë të motivuar, pasi fundjavën e kaluar mundën Vëllaznimin. Ndërkohë, mitrovicasit kanë 14 fitore e nëntë humbje, ndërsa

Vreshtarët tri fitore e 20 humbje. Takimi i dytë i së shtunës zhvillohet ndërmjet Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës. Kuqezinjtë synojnë "play-off"-in dhe numërojnë tetë fitore e 15 humbje, kurse prishtinasit janë në vendin e parë me 17 fitore e gjashtë humbje. Ndeshja e vetme e ditës së diel është në mes të skuadrave prizrenase Ponte

Prizrenit dhe Bashkimit. Takimi pritet të jetë interesant në derbin e qytetit. Ponte është në vendin e shtatë me shtatë fitore e 16 humbje, kurse "portokallezinjtë" kanë dhjetë fitore e 13 humbje. Ajka është për në fund. Derbi "verdhezi" zhvillohet të martën, ku përballen Golden Eagle Ylli dhe Peja. Ylli ka 17 fitore e gjashtë humbje, ndërsa pejanët kanë

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Rahoveci
17:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Bashkimi
19:00 Ylli - Peja

16 fitore e shtatë humbje, andaj pritet një superpërballje.



Kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 3 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është pritur të premtën nga ministri Armend Mehaj në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë takim ata diskutuan rreth ndeshjes së futbollit ndërmjet Ushtrisë së Kosovës (FSK) dhe Ushtrisë së Shqipërisë (FARSH), e cila do të mbahet në Kampin

Nacional në Hajvali më 7 mars në orën 13:00 për nder të Epopesë së UÇK-së. Me këtë rast kryetari Ademi theksoi se FFK-ja do të jetë mbështetëse e këtij eventit me të gjitha kapacitetet sportive. Në anën tjetër, ministri Mehaj shprehu mirënjohjen e tij për kreun e FFK-së për bashkëpunimin dhe gatishmërinë për të

organizuar evente sportive për FSK-në. Në fund të bisedës, kërret e të dy institucioneve arritën marrëveshje për nënshkrimin e një Memorandumi të Bashkëpunimit në fushën e sportit, që do të mundësojë organizimin e turneve të përbashkëta në të ardhmen dhe shfrytëzimin e aseteve të të dy institucioneve.

Fitim Susuri përforcon Prishtinën

PRISHTINË, 3 MARS - FC Prishtina ka nënshkruar kontratë me futbollistin nga Prizreni, Fitim Susuri. 23-vjeçari është zhvilluar si futbollist te Liria e Prizrenit, së fundmi për pak muaj ka qenë pjesë e Feronikelit 74. Në edicionin e kaluar te Liria,

Susuri ishte një nga futbollistët më në formë në Kosovë, ku kishte shkuar në kuotën e 10 golave dhe 10 asistimeve. Susuri është paraqitur edhe zyrtarisht në skuadër nga drejtori sportiv Driton Krasniqi. "Nuk besoj se ka futbollist në Kosovë që nuk

ndihet i kënaqur të luajë për Prishtinën. Ky është klub i madh dhe është nder dhe krenari që jam bërë pjesë e ekipit kryeqytetas", ka thënë Susuri. "Stafit të trajnerëve dhe tifozëve u premtoj se do ta jap maksimumin në çdo stërvitje dhe pastaj në ndeshje për të

kontribuar maksimalisht për skuadrën. Prishtina e ka një skuadër shumë të mirë me futbollistë shumë cilësorë dhe trajnerë të mirë andaj besoj se me punë dhe me angazhim do t'i arrijmë objektivat që i kemi në këtë edicion", ka deklaruar Susuri.



Vajza e legjendës Pele: Babai im ishte i lumtur kur mësoi që Messi u shpall kampion bote

SAO PAOLO, 3 MARS - Vajza e legjendës Pele, Kelly, ka rrëfyer se babai i saj ishte lumturuar kur mësoi se Argjentina dhe Lionel Messi kishin arritur kulmin duke fituar Botërorin. Pasi publikoi një fotografi të saj me Antonela Rokuzon, bashkëshorten e argjentinasi, ajo zbuloi se legjenda dëshironte që Kupa e Botës të qëndronte në Amerikën Latine. "Kur Brazili u eliminua nga Kroacia, gjendja e babait tim ishte përkeqësuar shumë. Të gjithë donin që kombëtarja jonë ta fitonte këtë trofe për babanë tim. Por ai e kuptonte futbollin më mirë se kushdo dhe ai gjithmonë thoshte, se donte për lojën e bukur, e cila ishte mundësia që çdo ekip të fitonte. Pas humbjes së Brazilit, kushdo që vinte në spital e pyeste: 'Po tani kë mbështet Pele? Sigurisht



që jo Argjentinën!'. Por ai thoshte: 'Po, Argjentinën! Kupa duhet të qëndrojë në Amerikën Latine dhe Messi e meriton'. Ai nuk ishte në gjendje ta shikonte finalen,

por kur kuptoi se Argjentina dhe Leo ishin në gjendje të ngrehin kupën, ai ishte i lumtur. Rroftë futbollit!", ka shkruar vajza e legjendës Pele.

Dallasi triumfon ndaj Philadelphias

DALLAS, 3 MARS - Dallasi arriti një fitore të rëndësishme në NBA, duke mundur me rezultat 133-126 Philadelphian në një ndeshje spektakolare mes dy ekipeve pretendente për titull. Dyshja Donçiq-Erving bëri diferencën në fushë për tekstanët, pasi së bashku ata realizuan 82 pikë. Në kahun tjetër, Embiid e mbylli me 35 pikë, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra kampione e Golden States, që mundi me rezultat 115-91 Clippersin në derbin kalifornian. Jordan Poole me 34 pikë ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes, lider për Warriorsin. Washingtoni, falë 30 pikëve të



Kuzmas dhe 25 të Porzingsit, mposhti 119-108 kanadezët e Torontos. Rikthehet te fitorja pas 13 humbjesh radhazi ekipi i San

Antonios, që e mundi me rezultat 110-99 Indianan. Për Spursin u dallua Sochan me 22 pikë e 13 rebounde.

REZULTATET

Washington - Toronto	119-108
Dallas - Philadelphia	133-126
San Antonio - Indiana	110-99
Golden State - Clippers	115-91

SHKURT

Ancelotti: Jemi optimistë për ndeshjen e kthimit

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, pavarësisht humbjes së pësuar në "Bernabeu", ka thënë se skuadra e tij ka dominuar në ndeshjen ndaj Barcelonës dhe kjo i jep besim për ndeshjen e kthimit. "Zhvilluam ndeshjen që dëshironim, nuk erdhi rezultati, por na jep besim për ndeshjen e kthimit. Jemi të kënaqur pasi nuk është e lehtë të kontrollosh ndeshjen siç e bëmë në kundërshtim me rivaleje si Barcelona. Ndeshjen e nisëm mirë, por paguam shtrenjtë një gabim individual. Në sfidën e kthimit duhet të zhvillojmë të njëjtin tip loje edhe pse jemi të sigurt se Barcelona nuk do të luajë në të njëjtën mënyrë përballë publikut të vet", ka thënë Ancelotti.

Xavi: Morëm rezultat të mirë, por Reali ka skuadër shumë të fortë

Barcelona e fitoi ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës ndaj Real Madridit (0-1). Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se skuadra e tij mori një rezultat të mirë, por duhet të ketë kujdes në ndeshjen e kthimit për faktin se Reali ka një skuadër shumë të fortë. "Rezultati është shumë i mirë, por është dhe ndeshja e kthimit. Jemi të kënaqur me ndeshjen e zhvilluar pasi limituam një skuadër si Real Madrid që krijon shumë raste për gol. Sigurisht se në ndeshjen e kthimit kemi një avantazh të rëndësishëm pasi do të luajmë përballë publikut tonë, por Real Madridi është shumë i fortë", ka deklaruar Xavi.

Mulleri sfidon Mbappen: Jemi gati!

Veterani i Bayern Munchenit, Thomas Muller, ka folur për sfidën e kthimit kundër PSG-së duke u ndalur te Kylian Mbappe dhe impakti që pritet të ketë ylli francez në ndeshjen kthyesë. "Kur u fut në fushë tregoi menjëherë cilësitë e tij. Realiteti është që nuk duhet ta humbasim asnjë moment nga shikimi, por fakt është se rastin e vetëm që pati ishte kur shënoi golin në pozicion jashtë loje. Një lojtar si ai gjendet gjithnjë në vendin e duhur për të shënuar. Absolutisht është një rrezik konstant. Mbase nga lojtarët e vetëm që mund të bëjë diferencën, por në Munchen ne do të bëjmë lojën tonë. Jemi të gjithë gati", ka thënë Mulleri.

Perezi synon titullin e kampionit në Formula 1

Piloti i Red Bullit, Sergio Checo Perez, duket se e ka të qartë se 2023 duhet të jetë viti në të cilin ai duhet të bëjë hapin e madh dhe ta shtyjë për vendin e parë në renditje për t'u kurorëzuar si mexsikani i parë që fiton një titull botëror në Formula 1. 33-vjeçari i lindur në Guadalajara foli për "Fox Sports", për dëshirat e tij në të ardhmen dhe problemet që kishte në të kaluarën me Max Verstappenin. Checo beson se pas 12 vjetësh në nivelin më të lartë në qarqet F1, duke kujtuar se ai filloi si testues në Sauber në 2011, ky fillim i sezonit duhet të jetë i tij pasi përfundoi i treti në 2022 në renditjen e përgjithshme pas holandezit dhe Charles Leclerc, i cili përfundoi vetëm tri pikë përpara tij. "Ne do të marrim pikë të mjaftueshme për të qenë kampionë. Ky është qëllimi im këtë sezon. Ne duam t'i bëjmë dy hapat e ardhshëm këtë sezon", ka thënë piloti i Red Bull.

Nadali mendon tërheqjen: S'jam më 20 vjeç, lëndimi në Australian Open ishte i rëndë

Rafael Nadal është ende duke u rikuperuar nga lëndimi që pësoi në Australian Open. Tenisti nga Majorka e nisi vitin 2023 me një tjetër dëmtim në karrierën e tij dhe që prej janarit nuk ka shkelur ende në fushë. Ai konfirmoi se do të mungojë në dy turnetë Masters të Indian

Wells dhe Miami. Për pasojë, Nadal do të dalë nga "top10" tenistët më të mirë në botë për herë të parë që nga viti 2005. Në një intervistë nga "Santiago Bernabeu", ku ishte duke parë "el clasico" Real Madrid-Barcelona, për rikthimin e tij në fushë, Nadal ka deklaruar: "Rikuperimi po ecën shumë

ngadalë. Po e vlerësoj gjendjen time javë pas javë, po bëj teste për të parë se si po ecën dëmtimi". "Nuk fola shumë pas Australian Open, por aty pata një problem të madh me dëmtimin. Ishte një çarje e madhe muskulore dhe një çarje e vogël e tendinës. Është një pikë shumë e ndërlikuar.

Ne tenistët marrim forcë nga atje. Nuk kam zgjidhje tjetër veçse të jem pak i durueshëm. Është e vërtetë që koha e kalendari ecën dhe nuk jam më 20 vjeç dhe pas një viti si ky që po përjetoj lodhesh, por unë bëj ç'të mundem", ka deklaruar Nadal. Tenisti po stërvitet në Manacor, në

akademinë e tij, deri kur të marrë dritën jeshile përfundimtare për ta forcuar stërvitjen e tij: "Çdo ditë stërvitem në akademi. Bëj palestër, rikuperim, 15 ose 20 minuta në fushë për të mos lënduar më tej krahun, por tani jam duke pritur për rikuperimin e madh".



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.12.2021, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës për një periudhë të pacaktuar, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 04.03.2023 të rishpall;

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e për Projektim dhe Zhvillim - me kohë të pacaktuar

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Harton strategjinë zhvillimore të kompanisë të mbështetur në planin strategjik të Bordit të Drejtorëve;
- Harton projektet të ndara sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit;
- Bënë zbatimin dhe zhvillimin e projekteve të kompanisë;
- Bënë mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave të projekteve të kompanisë;
- Ndihmon në menaxhimin, përditësimin e bazës së të dhënave të projekteve të kompanisë në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Kryen detyrat e dhëna në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Ruan dokumentacionin dhe procedurat e sakta dhe të plota të identifikuar për të gjithë projektin (hapat) në lidhje me funksionalitetin;
- Përpilon planin vjetor të punës dhe përcjellë realizimin e të njëjtit;
- Kryen edhe të gjitha punët tjera të kësaj natyre dhe punë tjera që i cakton eprori i drejtëpërdrejtë.

Kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- CV-në
- Të ketë Diplomë Universitare;
- Aftësi organizative, planifikuese dhe kordinuese;
- Preferohet njohja e gjuhëve të huaja;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 04.03.2023 deri më datën 18.03.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 24.02.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhë e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 04.03.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Pesë (5) Punëtor Fizik -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjashme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 04.03.2023 deri më datën 18.03.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Drejtoria e Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren

Nr.prot: 400

Data:03.03.2023

Mbështetur në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ- Aktivitetet jashtëkurrikulare Nr.02/2016 dhe në vendimin nr.prot. 319 të datë: 08.02.2023, të KDSH-së Gjinnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

FTESE PËR OFERTË

Për ekskursion të maturantëve të gjinnazit "Gjon Buzuku", Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjinnazit "Gjon Buzuku", nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datë 08.05. 2023 deri më 12.05.2023.

Paraqitësit në tender duhet ti plotësojnë këto kritere:

1. Çertifikatën e biznesit me informata për biznesin.
2. Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2022 në origjinale.
3. Vërtetimin e Administratës Tatimore që nuk ka borxhe për vitin 2022 në origjinale.
4. Licencën e transportit ndërkombëtar, "D"
5. Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit 2020,2021,2022.
6. Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli teknik.
7. Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
8. Autobusët të jenë komfort me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 450 vende
9. Çertifikatat mjeksore për vozitësit.
10. Kompania të siguroj mjekun (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
11. Dëshmi për hotelin e ofruar në Durrës.
12. Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr. telefonit i pronarit dhe adresa
13. Hoteli të posedoj mbi 450 shtretër. Të posedoj banjë dhe ujë të mjaftueshëm.
14. Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës.
15. Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi.
16. Të prezantoj Licencën e agjencionit të akreditimeve ushqimore në vendqëndrimin e nxënësve.
17. Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse nëpër monumente sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH-ja.
18. Hoteli të posedoj sallë për argëtim për nxënës- dhe të mos shërbehen apo lejoj shitjen dhe përdorimin e pijeve acoolike në tërë hapsirën e hotelit.
19. Oferta për nxënës të liruara nga pagesa.
20. Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për për tre vitet e fundit së paku 250000 euro.

Vërejtje: Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet ti siguroj nënshkrimet nga : Drejtori i shkollës, kryetari i KDSH së kryeatres së KN, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

P.s Lartësia e pagesës 130 euro

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompetuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë. Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016, me datën:10.03.2023 në ora 16:00, Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofrura nga kompanitë, ku do të bëhet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e Komisionit do të kenë Agjencionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh dhe nuk e tejkalojnë çmimin mbi 130 euro. Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania Turistike e përgjegjshme më çmimin më të ultë të ofertës. Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Auto Shkolla "Trimi" në Gjiilan, njofton kandidatët e interesuar për regjistrimin e patentë shoferit se për nder të festave të muajit mars bënë zbritje në pagesë.

- "INSIDER" L.L.C shpall të pavlefshme çertifikatën e biznesit më numër të regjistrimit: 71239969

- Skender Shotka shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Senahid Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Jeton Berisha shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Florim Aliaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Vlera Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Shkrije Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Melisa Malaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfm Ulët "Selman Riza" Piskot Gjakovë nga kl. VI-IX.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

